



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH Nr. 729.730/18

PANELI SHQYRTUES i emëruar nga kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues dhe z. Goran Milenkovic – anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2017 të dt:20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, /Korporata Energjetike e Kosovës/ të datë: 27.07.2018, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, përkitazi me operatorin ekonomik: NTP. "SNR" dhe OE "Union LLC", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pompa Centrifugale horizontale për largimin e ujit", me nr. prok: KEK-17-137, më dt. 29.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar, kërkesa e Autoriteti Kontraktues- (AK) / Korporata Energjetike e Kosovës/ me dt: 27.07.2018, ku AK-ja ka bërë kërkesë për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurim publik për operatorët ekonomik: NTP. "SNR" dhe OE "Union LLC", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pompa Centrifugale horizontale për largimin e ujit", me nr. prok: KEK-17-137, më dt. 29.08.2018, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/ me dt:27.07.2018, ka parashtruar kërkesë, ku ka theksuar se: Me anë të kësaj shkrese kërkoi nga OSHP që konform kompetencave që të veproj konform nenit 99.2 të LPP-së dhe të bëjë diskualifikimin e Operatoreve Ekonomik NTP. "SNR" dhe OE "Union LLC", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pompa Centrifugale horizontale për largimin e ujit",

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë: 31.07.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të përgatitur një kronologji lidhur me këtë kërkesë. Eksperti shqyrtues në kronologjinë e dt: 02.08.2018, sqaron:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datë: 27.07.2018 nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës KEK, ka pranuar kërkesë për diskualifikim të OE "UNION LLC dhe OE NTP SNR, ku kanë theksuar: "Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. me datën 10.06.2017 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit KEKC-17-137-, Furnizim me Pompa Centrifugale horizontale për largimin e ujit kurse hapja ofertave dashtë bere me datën 23.06.2017 në ora 12:00 dhe ka pranuar 9 (nëntë) oferta. Një nder kërkesat e dosjes se tenderit te neni 9.1 & 9.2-kërkesat Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te FDT-se ka qene qe OE ne ofertën e tyre te prezantojnë:Certifikatën e prodhuesit sipas standardeve ISO 9001:2008).

Ne ankesën e deponuar nga OE ND shpk nr.318/17 ne OSHP, ai pretendon se OE i rekomanduar për kontrata NTP SNR ka prezantuar certifikatën e kërkuar me dosje te tenderit ISO 9001:2008 te prodhuesit deklaruar te pompave Boda Industrial-Kind te falsifikuar dhe jovalide .

Pas zhvillimit te seancës se OSHP-se te mbajtur me dt.16.10.2017 Paneli i OSHP-së ka lëshuar Vendimin nr.318/17 te dt.23.10.2017 me te cilin dashtë pranuar ankesa e OE ND shpk dhe lënda ashte kthyer ne rivlerdsim .Paneli pas analizave, ka konstatuar se OE NTP SNR ne oferte ka prezantuar certifikatën ISO 9001:2008 me nr.0412S10034R5N te prodhuesit Boda Industrial Pump Co Ltd -Kind e cila është ne web faqe te prodhuesit Boda Industrial Pump Co Ltd mirëpo e njëjta nuk rezulton te jete ne fawn e lëshuesit te certifikatës Watson Technology Inspektion Co Ltd dhe si jovalide e pranon site bazuar ankesën e OE NDshpk për ketë pretendim.

Komisioni i ri-vlerësimit ne baze te këtij vendimi ,gjate ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit te ofertave ka shprehur dyshimin se Operatori Ekonomik NTP SNR ka prezantuar certifikatën e falsifikuar ISO 9001:2008 me date te skadimit 09.02.2018 e plasuar ne web fawn e prodhuesit Boda Industrial Pump Co Ltd-Kind me me nr.0412S10034R5N e lëshuar nga trupa certifikuese VTI Ltd-Kind ,dhe me qellim te verifikimit te kësaj certifikate i është drejtuar ne mdnyrd të pavarur lëshuesit te kësaj certifikate ISO 9001:2008 te prodhuesit Boda Industrial Pump Co Ltd-Kind me dt.02.11.2017 ,duke kërkuar qe te konfirmoj se kjo certifikate a është e lëshuar nga VTI ltd. Me dt.03.12.2017 kemi pranuar një përgjigje nga lëshuesi i certifikatës ISO 9001:2008 ,VTI-Kind se kjo certifikate është jovalide dhe nuk ashte e lëshuar nga VTI. Komisioni i rivlerësimit edhe përmes hulumtimit ne internet është munduar ta gjej certifikatën e prezantuar ne ueb sajtin e trupës certifikuese IQNET , por kjo ka qene e pamundur pasi qe nuk ka qene e regjistruar asnjë certifikate me numrin e lartcekur.

Nga përgjigja e pranuar komisioni i ri-vlerësimit ka konstatuar se certifikata e prezantuar ne oferte ashtë e falsifikuar.

Në seancën dëgjimore e cila është mbajtur me dt:29.08.2018, kanë marr pjesë paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues si dhe përfaqësuesi i AK-së, si dhe përfaqësuesi i OE NTP. "SNR" dhe OE "Union LLC", edhe pse është ftuar me ftesë të rregullt.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues znj.Hoti deklaroi: AK-KEK ka parashtruar kërkesë për marrje të masave konform nenit 99 të LPP-së me datë 27.07.2018 për OE:”Union LLC” dhe OE:”SNR” për të cilët dyshojnë se certifikatat ISO të ofruara nga OE-të janë të falsifikuara, bëhet fjalë për certifikatën ISO 9001:2008 me numër 0412S10034R5N të prodhuesit Boda Industrial Honme Co Ltd nga Kina. Komisioni vlerësues i AK-KEK ka dyshuar se OE:”NTP SNR” ka prezantuar certifikatat ISO 9001:2008 të falsifikuara dhe për këtë dyshim zyrtarët e AK-së kanë kërkuar sqarim nga lëshuesi i këtyre certifikatave. Për sqarime më të detajizuara do ja kaloja fjalën përfaqësuesit të AK-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit i AK-KEK z.Fazliu deklaroi: Ne nuk kemi të shtojmë më shumë se ajo çka kemi bashkangjitur në shkresat e lëndës. Gjatë një fazë të procedurës së këtij tenderi një OE ka pretenduar se certifikata e SNR nuk është lëshuar nga organi – lëshuesi Vatson Technology edhe pse në faqe të prodhuesit Boda kjo certifikata figuron, mirëpo pasi OE “ND”shpk ka pretenduar për të këtë certifikatë kemi kontaktuar lëshuesin e certifikatës me pyetje se a ka lëshuar atë certifikatë me numër konkret, dhe në përgjigje kanë thënë se ata nuk e kanë lëshuar këtë certifikatë. Edhe për OE:”Union LLC” është e njëjta situatë me të njëjtin prodhues për të njëjtën certifikatë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit i OE SNR z.Spahiu deklaroi: Konsiderojmë se kërkesa e AK-KEK është e pabazuar duke u nisur nga fakti se certifikata është vebsjatin zyrtar të Boda Industrial Ump dhe e njëjta i prezantohet OSHP paneli shqyrtues. PO ashtu theksojmë se ne nuk mund të mbajmë asnjë përgjegjësi nëse e njëjta mund të jetë e falsifikuar siç pretendon AK-KEK. Edhe pse AK në dokumentet e bashkangjitura me kërkesë i është drejtuar vetëm njërit prej lëshuesve të kësaj certifikate kurse dy organeve tjera nuk i është drejtuar për neve kjo kërkesë e AK është e pathemelt.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE Union LLC z.Bajgora deklaroi: Ne gjatë praktikave të dhënies së ofertave certifikata ISO në shumicën absolute i marrim nga vebfaqet e prodhuesve dhe nuk kemi asnjë mundësi për të vërtetuar dhe shohim vetëm afatin e valdiditetit dhe nuk kemi mundësi çdo certifikatë ta vërtetojmë. Ne nuk mund të mbajmë përgjegjësi nëse prodhuesi ka manipuluar diçka. Këtë e kemi thënë edhe në shkresën e drejtuar AK-së se distancohemi nga çdo manipulim i mundshëm i prodhuesit. Me gjithë atë si OE Union LLC pasi është hapë dyshimi nga AK se nuk është certifikatë e rregullt, ne si OE jemi tërhequr nga oferta për këtë aktivitet të prokurimit qysh në dhjetor të vitit të kaluar dhe nuk kemi vazhduar validitetin e ofertës. Me gjithë atë kërkojmë nga OSHP që të mos na fajësoj neve për diçka çka mund ta bëjë dikush në Kinë sepse si kompani siç ceka nuk kemi mundësi të vërtetojmë gjitha certifikatat e prodhuesve a janë të sakta apo jo.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit i AK z.Fazliu deklaroj: I propozojmë panelit të aprovohet kërkesa e AK-së konfrom LPP-së.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE "SNR" z.Spahiu deklaroj: I propozojmë panelit të refuzohet kërkesa e AK-së si e pabazuar.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE Union LLC z.Bajgora deklaroj: I propozojmë panelit të refuzohet si e pabazuar kërkesa e AK-së.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë nuk ka ofruar dëshmi se operatori ekonomik " NTP. "SNR" dhe OE "Union LLC", kanë ofruar ndonjë dokument të falsifikuar apo të dhëna të rreme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues në mungesë të dëshmive dhe argumenteve se operatori ekonomik " NTP. "SNR" dhe OE "Union LLC", ka ofruar ndonjë dokument të falsifikuar apo të dhëna të rreme, vjen në përfundim se kërkesa e AK-së, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të operatorit ekonomik OE " NTP. "SNR" dhe OE "Union LLC", është e pabazuar dhe e pa mbështetur në fakte dhe argumente konkrete dhe se kërkesa e autoritetit kontraktues nuk hynë në kuadër të kompetencave të OSHP-së, të parashikuara në nenin 99.2 të LPP.

Paneli shqyrtues konform nenit 99.2 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Korporata Energjetike e Kosovës;
- 1x1 OE NTP. "SNR";
- 1x1 OE "Union LLC";
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së .